



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke
Ministry of Education and Science



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

Datë 24. 02. 2021

KOMISIONI I PËRBASHKËT SHQIPËRI - KOSOVË PËR MIRATIMIT E TEKSTEVE MËSIMORE
PËR DIASPORËN

THIRRJE PËR APLIKIM NË KONKURSION PËR TEKSTIN MËSIMOR PËR MËSIMIN
PLOTËSUES NË DIASPORË DHE MËRGATË,
NIVELI I

Komisioni i Përbashkët Shqipëri – Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, shpall thirrjen për aplikim në konkursin për tekstin mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë, me titullin **“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli I.**

1. Teksti mësimor hartohet në përputhje me:
 - a. Kurrikulën e përbashkët të mëimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe Mërgatë”, Tiranë - Prishtinë, miratuar në prill 2018.
 - b. Standardet e teksteve mësimore për Diasporën, miratuar në shkurt 2021.
2. Ftohen të aplikojnë, shtëpitë botuese, që përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në **paketën e dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën**, miratuar në shkurt 2021 nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë i Republikës së

Shqipërisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Kosovës, si dhe Ministri i Shtetit për Diasporën i Republikës së Shqipërisë.

3. Subjekti aplikues paraqitet brenda kohës së orarit zyrtar të punës, te Komisioni i Përbashkët Shqipëri - Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën për të dorëzuar dokumentacionin ligjor dhe teknik, si dhe dorëshkrimin e tekstit mësimor përkatësisht:
 - a. Në datat **26-28 korrik 2021**, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në Prishtinë.
 - b. Në datat **29 – 31 korrik**, në Qendrën e Botimeve për Diasporën, në Tiranë.
4. Shpallja e rezultateteve të konkursit, si dhe shpallja e fituesit bëhet në muajin **gusht 2021**.
5. Aplikimet e paplota e të pasakta, që nuk janë në përputhje me përcaktimet e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të teksteve mësimore për Diasporën apo të kryera përtej afateve të parashikuara, do të refuzohen.
6. Për pyetje, lutemi na kontaktoni në adresën (info@qbd.gov.al)
7. Për shkarkimin e materialeve të nevojshme për aplikim dhe për hartimin e teksteve mësimore, **klikoni në linkun e mëposhtëm:**
<https://drive.google.com/drive/folders/1fOUmjNY9qIMKhUcQFQ0MVWj3DYyC41u9>